

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8344
E martë, 21 korrik 2026
Çmimi 0. 50 €

**Përparim Rama: Kosova
në izolim strategjik,
Qeveria të shpjegojë
raportet me SHBA-në**

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA SËRISH NË VENDNUMËRO: FONDET, REFORMAT DHE EKONOMIA NË RREZIK

FAQE 4-5



Bisedimet LV-LDK janë pezulluar, ndërsa opsionet për krijimin e institucioneve po ngushtohen.

Ekspertët thonë se i gjithë spektri politik mban përgjegjësi për daljen nga ngërçi. Vonesat

rrezikojnë fondet e BE-së, reformat dhe stabilitetin ekonomik të vendit

**NË RAFTET E
DYQANEVE,
IMPORTI MUND
PRODUKTIN
KOSOVAR**

F. 3



**MINISTRIA E
FINANCËVE
NËNSHKRUAN KATËR
MARRËVESHJE NË
KUADËR TË PROJEKTIT
PËR ZHVILLIMIN E
SEKTORIT FINANCIAR
ME BANKËN BOTËRORE**

F. 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



**PAKETA E RE E SANKSIONEVE TË
BE-SË NDAJ RUSISË NXJERR NË
PAH NDARJET E VAZHDUESHME**

F. 2

**ORGANIZATAT EVROPIANE:
LIRIA E MEDIAS NË KOSOVË
ËSHTË PËRKEQËSUAR**

F. 6

**KËSHILLI PROKURORIAL
I KOSOVËS REFUZON KËRKESËN E
PROKURORËVE SERBË PËR
TËRHEQJEN E DORËHEQJEVE**

F. 7

EKONOMI



**GJINI TAKON DREJTUESIT E ZRRË-SË,
KËRKON AVANCIMIN E GAZSJELLËSIT
DHE TERMOCENTRALIT**

F. 8

**HAPEN PROGRAMET E ZHVILLIMIT
TË AFTËSIVE PËR PËRFITUESIT
E NDIHMËS SOCIALE**

F. 8

SPORT



SPANJA KAMPIONE E BOTËS

F. 10

PAKETA E RE E SANKSIONEVE TË BE-së NDAJ RUSISË NXJERR NË PAH NDARJET E VAZHDUESHME

BRUKSEL, 20 KORRIK - Shumë diplomatë të Bashkimit Evropian mendonin se miratimi i sanksioneve ndaj Rusisë do të bëhej më i lehtë pas largimit në maj të ish-kryeministrit hungarez, Viktor Orban, pas 16 vjetësh në pushtet.

Duke qenë se shihej si udhëheqësi më miqësor ndaj Kremlinit në bllok, politikanë dhe diplomatë të tjerë evropianë shpesh ishin ankuar se Budapesti kishte zbutur si vendosjen në listën e zezë të individëve kryesorë rusë, ashtu edhe masat që synonin dobësimin e fuqisë ekonomike dhe ushtarake të Moskës.

Prandaj, pritshmëritë ishin të larta kur propozimi i Komisionit Evropian për paketën e 21-të të sanksioneve të BE-së qëkurse nisi pushtimi i plotë i Ukrainës në shkurt 2022 mbërriti në kryeqytetet evropiane në fillim të qershorit.

Dhe draftet e para, të siguruar nga Radio Evropa e Lirë, tregonin se kjo paketë ishte vërtet e mbushur me masa ambicioze.

Ende pa marrëveshje

Megjithatë, pothuajse gjashtë javë më vonë, ende nuk ka marrëveshje për të gjithë paketën, pasi të gjitha 27 shtetet anëtare të BE-së duhet të japin pëlqimin e tyre.

Një afat i vetëvendosur për 15 korrik - takimi i fundit i planifikuar të mërkurën i ambasadorëve të BE-së para ditës kombëtare të Belgjikës më 21 korrik, kur shumica e zyrtarëve të BE-së largohen për pushime në plazh deri në një muaj - kaloi pa ndonjë rezultat. Dhe për më tepër - pothuajse çdo masë është kufizuar ose hequr në një shkallë të tillë që diplomatët e BE-së me të cilët ka folur REL-i tani i referohen paketës si “Emmental”, sipas djathit të famshëm zviceran të mbushur me vrime.

Një nga propozimet kryesore ishte ndalimi i importit të peshkut rus - veçanërisht merlucit, kolesë dhe pollokut. Por, disa shtete anëtare, përfshirë Gjermaninë, Poloninë dhe Portugalinë, filluan të kërkonin përjashtime, pasi peshku rus përdoret për përpunimin vendas të ushqimit, duke përfshirë prodhimin e produkteve të peshkut. Në fund, masa u zbat qumë sa u hoq tërësisht.

Një histori e ngjashme ndodhi edhe me një tjetër propozim të madh: ndalimin automatik të hyrjes në zonën Shengen të ish-



luftëtarëve rusë në Ukrainë.

Estonia e kishte kërkuar me ngulm këtë masë, pasi gjatë vitit 2025 pati rritje prej 10 për qind të vizave turistike të lëshuara për shtetasit rusë krahasuar me vitin e kaluar, me Francën, Italinë dhe Spanjën që përbënin shumicën dërrmuese të tyre.

Pasi shumë vende mesdhetare nuk ishin të gatshme ta kufizonin turizmin - i cili është burim i madh të ardhurash - përpara një vere tjetër që pritet të jetë shumë e suksesshme, nuk u mor asnjë vendim konkret.

Në vend të kësaj, do të ketë vetëm një zotim për të kërkuar ndryshime në kodin e vizave Shengen për të ndaluar vizat afatshkurtra për ushtarët dhe ish-luftëtarët, nëse mund të arrihet njëzëshmëri e nevojshme.

Si të sanksionohet nafta?

Ka pasur gjithashtu shumë debate dhe shqetësime rreth kufirit të cmimit për naftën së papërpunuar Urals - përzierja kryesore e eksportit të Rusisë dhe një burim i konsiderueshëm të ardhurash për Kremlinin - pasi transporti i naftës dhe gazit përmes Ngushticës së Hormuzit muajt e fundit është ndaluar ose është kufizuar shumë për shkak të luftës në Lindjen e Mesme.

Propozimi fillestar i Komisionit Evropian ishte ngrirja e kufirit për gjashtë muaj në 44.10

dollarë për fuçi, në mënyrë që të shmangej rritja automatike në 60 dollarë më 15 korrik, gjë që do t'i siguronte një rritje të madhe arkës së luftës së Rusisë. Më pas, kjo periudhë u reduktua në tre muaj, para se ambasadorët e BE-së, duke iu afruar në mënyrë të rrezikshme afatit në fillim të kësaj jave, të binin dakord ta zgjasnin atë vetëm për shtatë ditë, deri më 23 korrik.

Ata do të takohen përsëri më 22 korrik me synimin për të arritur një marrëveshje përfundimtare, por e gjithë çështja është ndërlikuar nga kërkesa e Greqisë për një përjashtim pa afat nga një marrëveshje e bërë në tetor 2025 për ndalimin e dërgesave të gazit natyror të lëngshëm rus (LNG) nga BE-ja drejt vendeve jashtë bllokut, duke filluar nga 1 janari 2027.

Diplomatët e BE-së thonë se Athina argumenton se, nëse kompanive të BE-së u ndalohej transporti i LNG-së ruse drejt klientëve jashtë bllokut, biznesi thjesht do të zhvendoset te kompani transporti dhe porte jashtë BE-së, ndërsa Rusia do të vazhdojë të eksportoje karburantin.

Greqia thotë se për këtë arsye do të ishte më mirë që kompanitë e saj të vazhdonin t'i kryenin këto transportime.

Komisioni Evropian tani do të kryejë një vlerësim të shpejtë të ndikimit për të përcaktuar se sa mund të fitojë ose humbasë Rusia nëse miratohet ky

përjashtim.

Austria gjithashtu ka penguar miratimin e paketës duke kërkuar që banka e saj Raiffeisen të kompensohet për atë që Vjena pretendon se ishte një shpronësim prej 2.5 miliardë eurosh i operacioneve të saj në Rusi.

Vendi i Evropës Qendrore tentoi të njëjtën gjë edhe vitin e kaluar, duke i kërkuar Brukselit të konfiskonte dhe të shiste asete ruse të ngrira me vlerë 2 miliardë euro në Austri, shumica e të cilave përbëhen nga një pjesë aksionesh në grupin austriak të ndërtimit Strabag, që më parë mbahej nga Rasperia, një kompani dikur nën kontrollin e oligarkut rus Oleg Deripaska.

Austria argumenton se me këto të ardhura duhet të kompensohet Raiffeisen për humbjet që rrjedhin nga një vendim i gjykatës ruse në favor të Rasperias, një çështje që rezultoi në konfiskimin e operacioneve ruse të bankës.

Austria ka argumentuar se shumica e parave do të shkonin në një fond rindërtimi për Ukrainën dhe se kjo lëvizje do ta pengonte Kremlinin në të ardhmen që t'i përdorë vendimet e gjykatave ruse për të konfiskuar asetet e BE-së në Rusi.

Megjithatë, shtetet e tjera anëtare besojnë se një veprim i tillë do të rezultonte që Moska të inkurajohej të shënjestronte kompani të tjera evropiane që

ende ndodhen në vend.

Ato gjithashtu kanë shprehur bezdi ndaj idesë që BE-ja ta ndihmojë Raiffeisenin, e cila ka zgjedhur të qëndrojë në Rusi për të bërë biznes, ndërsa shumë qeveri të tjera evropiane vazhdimisht u kanë kërkuar kompanitë të tyre të largohen nga ai treg.

Përfundimisht, pritet që paketa të ketë shtim të numrit të bankave ruse në listën e zezë, si dhe të anijeve që besohet se janë pjesë e flotës së fshehtë ruse, e cila përdoret për t'i shmangur sanksionet ndaj naftës.

Mbi 250 individëve dhe kompanive ruse do t'iu ngrihen gjithashtu asetet. Ata gjithashtu do të përballen me ndalime vizash, përfshirë Arkadi Dvorkovich, ish-zëvendëskryeministër rus, i cili tani drejton Federatën Ndërkombëtare të Shahut, dhe ministrin rus të Sportit, Mikhail Degtyarev.

Por, edhe këtu lista është zbutur. Bullgaria ishte e shpejtë në vendosjen e vetos ndaj përfshirjes së tre emrave që ishin në propozimin fillestar: Patriarku Kirill, udhëheqësi i Kishës Ortodokse Ruse; Vagit Alekperov, drejtuesi i kompanisë më të madhe private të naftës në Rusi, Lukoil; dhe miliardi rus Iskandar Makhmudov, kompanitë e të cilit furnizojnë pjesë këmbimi për sistemin e metrosë në kryeqytetin bullgar, Sofje.

NË RAFTET E DYQANEVE, IMPORTI MUND PRODUKTIN KOSOVAR



PRISHTINË, 20 KORRIK - Pse një litër qumësht, një shishe vaj apo një produkt tjetër i prodhuar në Kosovë kushton shpesh më shumë se një produkt i ngjashëm i importuar?

Është një pyetje që, pashmangshëm, shtrohet nga konsumatorët përballë rafteve të dyqaneve, ku, në shumë raste, produktet vendore nuk arrijnë të konkurrojnë me çmimet e mallrave që vijnë nga jashtë.

Për prodhuesit, arsyeja nuk lidhet me cilësinë e produkteve, por me koston e prodhimit.

Ata thonë se energjia, transporti, paketimi, fuqia punëtore dhe lëndët e para e bëjnë prodhimin në Kosovë më të shtrenjtë, ndërsa produktet e importuara shpesh vijnë me avantazhin e subvencioneve shtetërore në vendet ku prodhohen.

Në industrinë e qumështit, për shembull, vetëm grumbullimi dhe transporti i qumështit deri në fabrikë kushtojnë rreth 60 centë për litër, thotë Alajdin Fusha, pronar i qumështores Abi në Prizren.

Më pas vijnë përpunimi, paketimi, energjia dhe shpenzimet e tjera. “Në fund, një litër qumësht në qese duhet të shitet rreth 80 deri në 85 centë vetëm për t’i mbuluar

kostot”, thotë Fusha për Radion Evropa e Lirë.

Ai tregon se produktet e tij - varësisht llojit - janë nga 10 deri në 20 centë më të shtrenjta se ato të importuara.

Por, fenomeni nuk kufizohet vetëm te qumështi. Në disa dyqane në Kosovë, edhe produkte të tjera vendore shiten me çmime të njëjta ose më të larta se ato të importuara.

Në një rast, një litër vaj i importuar kushtonte 1.72 euro, ndërsa një litër vaj i prodhuar në Kosovë 1.89 euro.

Përballë kësaj situatë, disa konsumatorë thonë se origjina e produktit ka kaluar në plan të dytë.

Ajo që vendos gjithnjë e më shpesh se çfarë përfundon në shportë, është kostoja.

Hana thotë se do të donte të blinte më shumë produkte vendore, por buxheti nuk ia lejon gjithmonë. “Qumështin dhe kosin zakonisht i marr vendore, por nëse janë më të shtrenjta, nuk mundem. E blej atë që është më lirë, edhe nëse është i importuar. Më vjen keq”, thotë ajo.

Edhe Gentiana Shatri thotë se gjatë blerjeve i kushton rëndësi vendit të origjinës së produktit, por vetëm pasi ta ketë parë çmimin. “E shoh edhe nga vjen produkti, por normalisht e shoh edhe çmimin”, thotë ajo.

Kjo prirje, sipas ekonomistëve dhe përfaqësuesve të biznesit, është bërë më e dukshme në një kohë kur fuqia blerëse e qytetarëve është vënë nën presion.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, kostot e prodhimit janë rritur për 2.3 për qind në tre muajt e parë të këtij viti.

Në të njëjtën kohë, inflacioni ka arritur në 6.8 për qind, i nxitur kryesisht nga shtrenjtimi i ushqimeve, transportit, energjisë, ujit dhe strehimit.

Ekonomistët vlerësojnë se si paga mesatare, e cila është 713 euro, si ajo minimale, e cila nga ky muaj është rritur në 500 euro, janë të pamjaftueshme për të përballuar rritjen e vazhdueshme të koston të jetesës për shumë familje.

Bizneset kërkojnë më shumë mbështetje nga shteti

Përfaqësuesit e bizneseve thonë se prodhuesit vendorë nuk mund ta fitojnë betejën me importin vetëm duke ulur fitimin.

Sipas tyre, problemi qëndron te kostot e larta të prodhimit dhe mungesa e politikave që do t’i bënin produktet kosovare më konkurruese.

Lulzim Rafuna, kryetar i Odës

Ekonomike të Kosovës, thotë se produktet vendore, në kushte normale, do të duhej të ishin deri në 15 për qind më të lira se ato të importuara. “Duhet t’i bindim qytetarët e Republikës së Kosovës që është patriotizëm ta blesh produktin vendor, edhe pse është 10 apo 20 centë më i shtrenjtë... dhe këta 10 apo 20 centë duhet Qeveria të shohë se si t’i ulë”, thotë Rafuna.

Për këtë, Oda Ekonomike propozon rritjen e mbështetjes financiare për prodhuesit, si dhe ndryshime në politikën fiskale, përfshirë rishikimin e TVSH-së për produktet bazë.

Çfarë bën shteti?

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) thotë se konkurrueshmëria e prodhuesve vendorë ndikohet nga një sërë faktorësh, përfshirë nivelin e teknologjisë, produktivitetin, kostot e energjisë, qasjen në financa, certifikimin sipas standardeve ndërkombëtare dhe varësinë nga importi i lëndës së parë.

Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, ministria thotë se është duke analizuar pengesat kryesore me të cilat përballen bizneset, me synim hartimin e masave që do të rrisin

konkurrueshmërinë e tyre.

Sipas saj, një nga format kryesore të mbështetjes janë grantet për blerjen e makinerive moderne, digjitalizimin, teknologjitë e reja dhe përmirësimin e proceseve të prodhimit. “Vlera e granteve për makineri është rritur nga 425 mijë euro në vitin 2021 në 6.8 milionë euro në vitin 2025, ndërsa për vitin 2026 janë paraparë pesë milionë euro”, thuhet në përgjigjen e ministrisë.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve, shifrat e tregtisë së jashtme tregojnë se ekonomia e Kosovës vazhdon të mbështetet kryesisht tek importi.

Vetëm gjatë gjysmës së parë të këtij viti, Kosova importoi mallra me vlerë mbi 3.5 miliardë euro, ndërsa eksportet arritën në rreth 521 milionë euro.

Edhe një vit më parë, diferenca ishte e thellë: importet tejkaluan shtatë miliardë euro, ndërsa eksportet e produkteve kosovare ishin rreth 950 milionë euro.

Për Alajdin Fushën, pronar i qumështores Abi, kjo tregon se prodhuesit vendorë kanë nevojë për më shumë mbështetje. “Shteti duhet të subvencionojë përpunimin e çdo litri qumësht. Vetëm kështu mund të bëhemi më konkurrues ndaj produkteve të importuara”, përfundon ai.



Enver Dugolli emërohet zëvendësministër i parë në Ministrinë e Punëve të Brendshme

PRISHTINË, 20 KORRIK - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin

Kurti, ka emëruar Enver Dugollin në pozitën e zëvendësministrit të parë në Ministrinë e Punëve të

Brendshme. Kryeministri Kurti e uroi Dugollin për detyrën e re dhe i

dëshiroi suksese në përbushjen e përgjegjësisë të reja.



KOSOVA SËRISH NË VENDNUMËRO: FONDET, REFORMAT DHE EKONOMIA NË RREZIK

Bisedimet LV-LDK janë pezulluar, ndërsa opsionet për krijimin e institucioneve po ngushtohen. Ekspertët thonë se i gjithë spektri politik mban përgjegjësi për daljen nga ngërçi. Vonesat rrezikojnë fondet e BE-së, reformat dhe stabilitetin ekonomik të vendit

PRISHTINË, 20 KORRIK - Çdo ditë pa institucione të reja e bën faturën e krizës politike në Kosovë më të lartë: miliona euro nga fondet e Bashkimit Evropian mund të humbasin, reformat kanë mbetur pezull, bizneset dhe investitorët përballen me pasiguri...

Më shumë se një muaj pas zgjedhjeve parlamentare të 7 qershorit, partitë politike ende nuk kanë gjetur formulën për krijimin e institucioneve të reja. Në vend të sinjaleve për kompromis, zhvillimet e ditëve të fundit kanë shtuar pasigurinë se kur Kosova do të ketë një Kuvend funksional dhe një Qeveri të re.

Shpresa për një marrëveshje të shpejtë u zbeh më 15 korrik, kur kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir

Abdixhiku, njoftoi se do t'i pezullojë bisedimet me partinë fituese, Lëvizjen Vetëvendosje, për shkak të nismës së disa bashkëpartiakëve për shkarkimin e tij.

Një koalicion mes LV-së dhe LDK-së shihej si alternativa më e mundshme për krijimin e institucioneve - nga Kuvendi deri te presidenti.

LV-ja thotë se vazhdon të mbetet e gatshme për marrëveshje me partitë shqiptare. "Ne përpiqemi maksimalisht. Jemi aktivë e konstruktivë për takime dhe bashkëbisedime, të hapur e të sinqertë për marrëveshje. Shpresojmë që opozita nuk do të barrikadohet kundër dhe të na çojë sërish në zgjedhje", thotë për Radion Evropa e Lirë zëdhënësi i Qeverisë në detyrë,

Arlind Manxhuka.

Radio Evropa e Lirë kontaktoi disa figura të LDK-së, përfshirë Armend Zemajn, Florian Dushin dhe Lutfi Hazirin, për t'i pyetur nëse zhvillimet brenda partisë së tyre rrezikojnë negociatat për formimin e institucioneve të reja dhe sa përgjegjësi mban LDK-ja për këtë proces, por asnjëri prej tyre nuk iu përgjigj kërkesës për koment.

Sekretari i LDK-së, Ilir Ferati, tha të enjten para gazetarëve se mbajtja e Kuvendit të jashtëzakonshëm të partisë është bërë urgjente, për shkak të afatit për konstituimin e institucioneve.

Ai nuk tregoi se kur mund të mbahet ai takim, ndërkohë që afati kushtetues për konstituimin e Kuvendit të

Kosovës është 7 gushti.

Dy partitë e tjera që, të paktën teorikisht, mund të siguronin një shumicë të qëndrueshme parlamentare me LV-në, e kanë bërë tashmë të qartë qëndrimin e tyre: Partia Demokratike e Kosovës ka thënë se do të mbetet në opozitë, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk i është përgjigjur as ftesës së parë të kryetarit të LV-së, Albin Kurti, për takim.

A ka mbetur një rrugëdalje?

Analisti politik dhe profesori i Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, Rrahman Paçarizi, thotë se ngërçi aktual nuk është krijuar vetëm nga zhvillimet e fundit në LDK, por është rezultat i raporteve të ndërtuara ndër vite ndërmjet partive politike. Sipas tij, refuzimi i PDK-së dhe AAK-së për të hyrë në koalicion

me LV-në lidhet me këto raporte, ndërsa zhvillimet e fundit në LDK e kanë zbehur edhe mundësinë që kjo parti të bëhet partneri i LV-së.

Ai dyshon se LDK-ja, edhe nëse arrin ta tejkalojë krizën e brendshme, do të mund t'i sigurojë të 18 votat e deputetëve të saj për një marrëveshje me LV-në. "Pavarësisht nga rezultati, LDK-ja do të dalë jounike nga Kuvendi i saj, nëse për asgjë tjetër, atëherë të paktën në kuptim të mundësisë së orientimit të 18 votave drejt një marrëveshjeje eventuale", thotë Paçarizi për Radion Evropa e Lirë.

Ai vlerëson se përgjegjësia për zhbllokimin e situatës nuk mund t'i lihet vetëm një partie dhe shton se përpjekjet për ta zhvendosur fajin te kundërshtari, vetëm sa e afrojnë vendin drejt një fushate të re zgjedhore, në vend se drejt një marrëveshjeje. "Ky lloj i ndërtimit të rrëfimit çon kah

një situatë e re parazgjedhore, ku subjektet politike përpiqen të marrin sa më pak faj mbi vete. Nëse duam të diskutojmë fajin, partitë politike, përgjithësisht, e kanë pjesën e tyre të përgjegjësisë dhe të meritave për cilëndo nga situatat që krijohen”, thotë Paçarizi.

Qëndrim të ngjashëm ka edhe Njomza Arifi, drejtoreshë ekzekutive në Grupin për Studime Juridike dhe Politike (GLPS).

Ajo thotë se, ndonëse përgjegjësia kryesore për krijimin e institucioneve bie mbi partinë fituese të zgjedhjeve, zgjidhja kërkon angazhim nga i gjithë spektri politik.

“Në secilin rast, i gjithë spektri politik duhet të angazhohet në gjetjen e një konsensusi që sjell stabilitet institucional afatgjatë në vend, duke u zhveshur nga interesat partiake”, thotë Arifi për Radion Evropa e Lirë.

Sipas saj, negociatat mes LV-së dhe LDK-së krijuan fillimisht përshtypjen se një marrëveshje ishte e mundur, por zhvillimet e fundit në LDK e çuan këtë perspektivë në pikëpyetje. “Se a është ky shansi i fundit i humbur mbetet e paqartë, për shkak se nuk dihet se kur mund të mblidhet Kuvendi i LDK-së dhe cili do të jetë epilogu i tij, duke pasur parasysh edhe afatet kushtetuese që tashmë kanë filluar të rrjedhin”, thotë Arifi.

Lëvizja Vetëvendosje, së bashku me deputetët e pakicave joserbe që tradicionalisht mbështesin formimin e

institucioneve, ka vota të mjaftueshme për konstituimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e kryetarit të tij.

Por, sfida fillon menjëherë pas këtij hapi: zgjedhja e presidentit kërkon të paktën 80 vota në Kuvend - numra që LV-ja nuk i ka.

Pikërisht për këtë arsye, Kurti ka nisur javën e kaluar negociatat me partitë e tjera shqiptare.

Nëse presidenti nuk zgjidhet brenda afatit kushtetues - deri në 60 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit - vendi shkon automatikisht në zgjedhje të reja.

Koha nuk është në anën e Kosovës

Pas takimit që zhvilloi me Abdixhikun më 10 korrik, Kurti deklaroi se kishte ende kohë për të gjetur një marrëveshje për konstituimin e institucioneve. Por, sipas njohësve të zhvillimeve politike, çdo ditë e humbur e bën më të rëndë çmimin e ngërçit institucional. “Zvarritja gjithmonë ka kosto”, thotë Paçarizi.

Sipas tij, Kosova tashmë po humb terren në raport me partnerët ndërkombëtarë, në një kohë kur vendet e tjera të rajonit po avancojnë në procesin e integritimit evropian. “Bota, përkatësisht institucionet e BE-së, NATO-ja e të tjerat, nuk i përshtatin oraret me tekat tona meskine dhe të vogla. Ne jemi ata që duhet t’u përshtatemi dinamikave të tyre”, thotë

Paçarizi.

Pas gati dy vjetësh bllokadë institucionale, Arifi thotë se çdo vonesë e re dërgon sinjale negative te partnerët ndërkombëtarë dhe e lë Kosovën edhe më prapa në procesin e integritimit evropian. “Me pothuajse dy vjet stagnim, vendi ynë vazhdon të dërgojë sinjal negativ te partnerët ndërkombëtarë... Kosova nuk gëzon as statusin e vendit kandidat dhe mbetet e fundit në procesin e negociimit me Bashkimin Evropian”, thotë ajo. Por, kostoja e vonesave nuk matet vetëm me ritmin e integritimit evropian.

Ngërçi politik tashmë ka filluar të reflektohet edhe në financat publike - me rrezikun që Kosova të humbasë dhjetëra miliona euro nga fondet e Planit të Rritjes të BE-së.

Gazetari me përvojë në çështjet evropiane, Augustin Palokaj, thotë për Radion Evropa e Lirë se mungesa e institucioneve funksionale rrezikon zbatimin e reformave që janë kusht për përfitimin e këtyre fondeve. “Nuk është sekret as në Bruksel e as në Prishtinë se arsyeja kryesore e humbjes së këtyre mjeteve është kriza politike dhe mungesa e institucioneve, përmes të cilave do të kalonin reformat, pasi një pjesë e tyre duhet të miratohen në Kuvendin e Kosovës”, thotë Palokaj.

Kosova e dorëzoi raportin për zbatimin e hapave reformues më 15 korrik, në ditën e fundit të afatit.

Burime të Komisionit Evropian i konfirmuan Radios Evropa e

Lirë se raporti tashmë është pranuar dhe se do t’i nënshtrohet vlerësimit.

Në bazë të këtij procesi do të përcaktohet se sa reforma janë zbatuar dhe sa fonde mund të shpërndahen.

Vetë kryenegociatori i Kosovës me BE-në, Jeton Zulfaj, paralajmëroi ditë më parë se vendi rrezikon të humbasë mbi 40 milionë euro, pikërisht për shkak të vonesave në zbatimin e reformave.

Ai sqaroi se pesë nga gjashtë reformat e pambyllura varen nga miratimi i ligjeve në Kuvend - një proces që ka mbetur i bllokuar për shkak të mosfunksionimit të institucioneve.

Palokaj thotë se ekziston rreziku që një pjesë e mjeteve të humbura, të mos rikuperohen më. “Fondet e pashfrytëzuara nga Kosova, Serbia apo Bosnje e Hercegovina mund t’u riallokohen vendeve që kanë përmbushur me më shumë sukses kriteret, si Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Shqipëria”, thotë ai.

Në kuadër të Planit të Rritjes 2024-2027, Kosovës iu ndanë rreth 882 milionë euro - 253 milionë euro grante dhe 629 milionë euro kredi - duke e bërë atë përfituesen më të madhe për kokë banori në Ballkanin Perëndimor.

Pasojat nuk ndalen te fondet e BE-së

Përtej fondeve evropiane, pasojat e ngërçit politik i ndien edhe ekonomia.

Profesori i kësaj fushe në Universitetin e Prishtinës, Mejd Bektashi, thotë se mungesa e institucioneve funksionale frenon vendimmarrjen ekonomike, dobëson besimin e

investitorëve dhe e bën më të vështirë planifikimin afatgjatë për bizneset.

Një nga pasojat më të dukshme, sipas tij, është rritja e çmimeve.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë se inflacioni në qershor ishte 6% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar - i nxitur nga shtrenjtimi i transportit, strehimit, energjisë, ujit dhe produkteve ushqimore.

Nëse pasiguria politike vazhdon, paralajmëron Bektashi, ajo mund të rrezikojë edhe stabilitetin financiar. “Inflacioni i lartë ul depozitat në bankat komerciale, rrit nevojën për kredi dhe shton barrën financiare për qytetarët”, thotë Bektashi për Radion Evropa e Lirë.

Ai shton se pasiguria institucionale i bën edhe investitorët e huaj më të rezervuar, ndërsa prodhuesit vendorë e kanë më të vështirë të zgjerojnë aktivitetin. Si pasojë, ekonomia mbetet gjithnjë e më e varur nga importet.

E, këtë e tregojnë edhe të dhënat e ASK-së: gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti, vlera e importeve arriti në rreth 3.6 miliardë euro, nga 3.2 miliardë euro në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.



ORGANIZATAT EVROPIANE: LIRIA E MEDIAS NË KOSOVË ËSHTË PËRKEQËSUAR

PRISHTINË, 20 KORRIK - Liria e medias në Kosovë ka hyrë në një periudhë të qartë përkeqësimit, si pasojë e ndërhyrjeve politike, sulmeve verbale ndaj gazetarëve dhe dobësimit të pavarësisë së institucioneve mediale, thuhet në raportin e publikuar më 20 korrik nga organizatat partnere të Platformës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Gazetarisë dhe Sigurisë së Gazetarëve. Raporti u hartua pas një misioni ndërkombëtar faktmbledhës, i zhvilluar në Prishtinë më 24-26 mars të këtij viti nga përfaqësues të tetë organizatave ndërkombëtare për lirinë e medias, përfshirë: Reporterët pa Kufij (RSF), Institutin Ndërkombëtar të Shtypit (IPI), Federatën Evropiane të Gazetarëve (EFJ), Qendrën Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Mediave (ECPMF) dhe Unionin Evropian të Transmetuesve (EBU), me mbështetjen e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës. Delegacioni zhvilloi takime me kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, gazetarë, redaktorë, përfaqësues të RTK-së, Komisionit të Pavarur të Mediave, sistemit të drejtësisë, organizatave të shoqërisë civile dhe diplomatë ndërkombëtarë. Në përfundim të misionit, organizatat vlerësojnë se, ndonëse Kosova vazhdon të ketë një peizazh mediatik pluralist, nivel relativisht të ulët të sulmeve fizike ndaj gazetarëve dhe një kornizë ligjore kryesisht të harmonizuar me standardet evropiane, këto zhvillime janë zbehur nga një klimë gjithnjë e më problematike për lirinë e medias. Raporti identifikon disa arsye kryesore për këtë vlerësim: ligjin për Komisionin e Pavarur të

Mediave, i cili më vonë u shpall antikushitetues, problemet me financimin dhe pavarësinë e Radio Televizionit të Kosovës (RTK), si dhe shtimin e sulmeve verbale dhe diskreditimit të gazetarëve nga politikanët, veçanërisht nga përfaqësues të partisë në pushtet. Sipas raportit, këto zhvillime kanë ndikuar edhe në renditjen ndërkombëtare të Kosovës. Në Indeksin Botëror të Lirisë së Mediave të Reporterëve pa Kufij për vitin 2026, Kosova renditet e 84-ta nga 180 vende, duke rënë për 28 pozita, krahasuar me vitin 2023. Organizatat paralajmërojnë se kjo ka dëmtuar reputacionin e Kosovës si një nga vendet më të avancuara në rajon për lirinë e medias dhe i bëjnë thirrje Qeverisë së ardhshme që ta rikthejë besimin në institucionet demokratike dhe në procesin e reformave. Radio Evropa e Lirë kërkoi koment nga Zyra e Kryeministrit lidhur me këto gjetje dhe është në pritje të përgjigjes. Përndryshe, një pjesë e konsiderueshme e raportit i kushtohet edhe sigurisë së gazetarëve. Sipas autorëve, megjithëse sulmet fizike kanë rënë krahasuar me vitin 2023, gazetarët përballen gjithnjë e më shumë me kërcënime verbale, fushata diskreditimi dhe ngacmime në internet, që shpesh burojnë nga figura të larta politike. Vetëm gjatë vitit 2025, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës regjistroi 69 raste që përfshinin gazetarë dhe media, përfshirë raste denigrimi publik, diskreditimi dhe sulmesh online. Raporti vëren se një pjesë e konsiderueshme e këtyre rasteve lidhen me deklarata ose veprime



të zyrtarëve publikë dhe politikanëve. Delegacioni shpreh shqetësim edhe për retorikën e përdorur ndaj gazetarëve, duke përmendur raste kur kryeministri Kurti ka kritikuar mediat ose gazetarët publikisht. Sipas raportit, organizatat i kanë bërë thirrje kryeministrit dhe partisë së tij që të shmangin gjuhën denigruese ndaj gazetarëve dhe të japin shembull për një debat publik më të respektueshëm. Raporti thekson se gjatë takimit me delegacionin, Kurti nuk e pranoi seriozitetin e shqetësimeve lidhur me sigurinë e gazetarëve, ndërsa më vonë Zyra e Kryeministrit, në përgjigje me shkrim, tha se ai nuk mbështet dhe nuk toleron sulmet verbale ndaj gazetarëve dhe se vetë nuk ka përdorur gjuhë fyese ndaj tyre. Raporti, po ashtu, ngre shqetësime për gjendjen në

transmetuesin publik RTK. Sipas organizatave, financimi i pamjaftueshëm, paqartësitë ligjore dhe pretendimet për presion politik kanë krijuar një situatë që rrezikon pavarësinë editoriale të transmetuesit publik. Delegacioni përmend dëshmitë e gazetarëve për largime nga emisionet, procedura disiplinore dhe ndërprerje emisionesh, ndonëse menaxhmenti i RTK-së i ka mohuar këto pretendime. Një kapitull i veçantë i kushtohet Komisionit të Pavarur të Mediave. Raporti rikujton se ligji për KPM-në, i miratuar nga Kuvendi në vitin 2024, u rrëzua më pas nga Gjykata Kushtetuese, e cila konstatoi se cenonte pavarësinë e institucionit. Organizatat shprehin shqetësim se edhe procesi i mëvonshëm i përzgjedhjes së anëtarëve të rinj të KPM-së dhe bordit të RTK-së është zhvilluar me procedura të përsheptuara dhe jotransparente, duke ngritur

dyshime për ndërhyrje politike. Raporti kritikon, gjithashtu, nivelin e transparencës së institucioneve publike. Gazetarët i kanë thënë delegacionit se qasja në informata zyrtare mbetet e vështirë, se konferencat për media janë të rralla dhe se komunikimi me zyrtarët është i kufizuar. Organizatat vënë në dukje edhe rritjen e vazhdueshme të numrit të ankesave për moslejimin e qasjes në dokumente publike gjatë viteve të fundit. Megjithatë, raporti evidenton edhe disa zhvillime pozitive. Organizatat vlerësojnë bashkëpunimin me sistemin gjyqësor, duke përmendur trajtimin më të shpejtë të rasteve që lidhen me gazetarët dhe miratimin e Strategjisë 2026-2028 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e cila, mes tjerash, u jep përparësi rasteve që lidhen me sigurinë e gazetarëve dhe shpifjen.

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS REFUZON KËRKESËN E PROKURORËVE SERBË PËR TËRHEQJEN E DORËHEQJEVE

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbledhjen e 20 korrikut, refuzoi kërkesën e pesë prokurorëve serbë dhe 15 punonjësve administrativë të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për tërheqjen e dorëheqjeve që kishin paraqitur në nëntor të vitit 2022, në kuadër të largimit kolektiv të serbëve nga institucionet e Kosovës. Në atë kohë, përveç pjesëtarëve të Policisë së Kosovës dhe punonjësve të pushtetit lokal, dorëheqje kanë dhënë edhe rreth 130 gjyqtarë, prokurorë dhe punonjës administrativë të sistemit të drejtësisë në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok. Dorëheqjet janë nxitur nga Lista



Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë, e mbështetur nga Beogradi - në shenjë

kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për t'i hequr nga përdorimi targat e

automjeteve të lëshuara nga Serbia dhe për t'i zëvendësuar ato me targa të Kosovës. Vendimin përfundimtar për shkarkimin e prokurorëve serbë duhet ta marrë ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu. Ajo, në mes të qershorit, kërkoi nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial që t'i përfundojnë "pa vonesë" të gjitha procedurat, duke vlerësuar se zvarritja ndikon në funksionimin normal të sistemit të drejtësisë. Vendimi i Këshillit Prokurorial për refuzimin e kërkesave u mor me propozimin e nënkryetarit të këtij institucioni, Dardan Vuniqi. Kryesuesi i Këshillit, Arian Gashi, kishte propozuar që çështja të shqyrtohej në një mbledhje të ardhshme, me arsyetimin se

paraprakisht duhej të konsultohesh edhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës thanë për Radion Evropa e Lirë se ende nuk kanë marrë vendim lidhur me kërkesat e gjyqtarëve serbë për tërheqjen e dorëheqjeve. Ata shtuan se opinioni do të njoftohet me kohë, por nuk dhanë detaje se sa gjyqtarë dhe punonjës administrativë nga komuniteti serb në veri kanë kërkuar rikthimin në detyrë. Çështja e dorëheqjeve të pazgjidhura u rikthye në vëmendje në mes të qershorit. Bashkimi Evropian deklaroi më 15 korrik për Radion Evropa e Lirë se ajo është duke u trajtuar në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Tre kosovarë humbin jetën në një aksident trafiku në Maqedoninë e Veriut

PRISHTINË, 20 KORRIK - Tre qytetarë nga Vushtrria humbën jetën në një aksident trafiku në Maqedoninë e Veriut, pasi vetura me të cilën po udhëtonin, doli nga rruga dhe u gjet e përmbytur në aksin mes pikëkalimit kufitar Bllacë dhe Shkupit, pranë kufirit me Kosovën. Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë së Veriut bëri të ditur se automjeti, një "Mercedes" me targa gjermane, u gjet mbrëmjen e 19 korrikut, rreth orës 22:35.

Në vendin e ngjarjes, policia gjeti tre persona pa shenja jete - një burrë dhe dy gra. Ekipi i ndihmës së shpejtë konfirmoi vdekjen e tyre. Sipas autoriteteve maqedonase, disa orë më herët, një shtetas i Kosovës kishte raportuar në polici zhdukjen e tre personave. Kontakti i fundit me ta ishte regjistruar mbrëmjen e 18 korrikut, kur ata ndodheshin në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit. Vdekjen e tre qytetarëve e

konfirmoi edhe kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi. Në shenjë zie, komuna njoftoi se janë shtyrë koncertet e planifikuara në kuadër të manifestimit "Ditët e Diasporës 2026". Komuna shprehu ngushëllime për familjet Tërnavë dhe Shabani, duke theksuar se vendimi për shtyrjen e aktiviteteve është marrë në shenjë respekti dhe solidarizimi me familjarët e viktimave. Ngushëllime shprehu edhe



ushtruesja e detyrës së institucionet e Kosovës presidentit të Kosovës, Albulena bashkëndojnë me familjarët në Haxhiu, duke theksuar se këto momente të rënda.

PËRPARIM RAMA: KOSOVA NË IZOLIM STRATEGJIK, QEVERIA TË SHPJEGOJË RAPORTET ME SHBA-në

PRISHTINË, 20 KORRIK - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka reaguar lidhur me zhvillimet e fundit në marrëdhëniet ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Serbisë dhe Kosovës, duke shprehur shqetësimin e tij për, siç e cilëson ai, përqendrimin e raporteve mes Prishtinës dhe Uashingtonit. Në një postim publik, Rama thekson se SHBA-ja ka nisur Dialogun Strategjik me Serbinë, duke përfshirë fusha si energjia, siguria energjetike,

infrastruktura, rrjeti 5G, mbrojtja, industria ushtarake, arsimi, shkenca dhe teknologjia. Sipas tij, në anën tjetër, Departamenti Amerikan i Shtetit ka bërë të ditur se Dialogu Strategjik me Kosovën mbetet i pezulluar, ndërsa ish-ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka paralajmëruar se reputacioni i Kosovës në Uashington ka pësuar goditje serioze. Rama vlerëson se këto janë sinjale shqetësuese nga aleati kryesor i Kosovës dhe kërkon



nga kryeministri që t'u japë gjendjen e marrëdhënieve me qytetarëve sqarime për SHBA-në. "Si ka mundësi që

marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara kanë arritur në pikën ku partneriteti strategjik është i pezulluar, besimi është vënë në pikëpyetje dhe Uashingtoni flet publikisht për kushtet që Kosova duhet t'i përmbushë?", shkruan Rama. Ai shton se Qeveria duhet të shpjegojë se si marrëdhëniet me aleatin më të madh strategjik të Kosovës kanë arritur, sipas tij, në pikën më të ulët që kanë njohur ndonjëherë raportet ndërmjet dy vendeve.

MINISTRIA E FINANCIVE NËNSHKRUAN KATËR MARRËVESHJE NË KUADËR TË PROJEKTIT PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT FINANCIAR ME BANKËN BOTËRORE

PRISHTINË, 20 KORRIK - Ministria e Financave ka nënshkruar katër marrëveshje me tri institucione vendore në kuadër të Projektit për Zhvillimin e Sektorit Financiar, i cili po zbatohet me mbështetjen e Bankës Botërore përmes Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA). Marrëveshjet synojnë forcimin e sektorit financiar, rritjen e qasjes në financa për bizneset, modernizimin e sistemeve të pagesave dhe fuqizimin e mekanizmave për mbrojtjen e depozituesve. Në kuadër të këtyre



marrëveshjeve, me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore është nënshkruar marrëveshje

granti në vlerë prej 4.7 milionë euro e dedikuar për rritjen e kapitalit dhe zgjerimin e

garancive kreditore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, me fokus në bizneset në pronësi të grave, startup-et dhe bizneset eksportuese. Gjithashtu, është nënshkruar marrëveshje granti prej 4.75 milionë euro me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës për krijimin e një Sistemi Modern dhe të Ndërveprueshëm të Pagesave të Shpejta, i cili do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit të pagesave digjitale në vend. Me Fondin Kosovar për

Sigurimin e Depozitave janë nënshkruar marrëveshje kredie dhe granti, secila në vlerë prej 11.85 milionë euro, për kapitalizimin e Fondit, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe mbështetjen e rritjes së limitit të mbulimit të depozitave të siguruara. Ministria e Financave mbetet e përkushtuar në zbatimin e reformave që forcojnë stabilitetin e sektorit financiar, përmirësojnë qasjen në financa për bizneset dhe avancojnë modernizimin e shërbimeve financiare në Republikën e Kosovës.

Policia e Kosovës avancohet kapacitetet në kërkim-shpëtim në ujë dhe zhytje

PRISHTINË, 20 KORRIK - Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Shoqatën e Kosovës për Kërkim dhe Shpëtim (SHKKSH), ka realizuar dy trajnime të specializuara "Kërkim-shpëtim në ujë" dhe "Zhytje", të zhvilluara në datat 5 - 10 korrik 2026 dhe 12 - 18 korrik 2026, në Borsh, Shqipëri. Në këto trajnime kanë marrë pjesë gjithsej 30 operatorë nga njësitë speciale të

Departamentit të Njërive Speciale të Policisë së Kosovës, të cilët kanë avancuar njohuritë teorike dhe aftësitë praktike në fushën e zhytjes, kërkimit dhe shpëtimit në ambiente ujore. Realizimi i këtyre trajnimeve ka kontribuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe operative të pjesëtarëve të njërive speciale të Policisë së Kosovës, duke rritur gatishmërinë e tyre për reagim

të shpejtë dhe efektiv në situata emergjente natyrore dhe civile. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në vazhdimin e zhvillimit të kapaciteteve në fushën e kërkim-shpëtimit, përmes trajnimeve të specializuara dhe avancimit të vazhdueshëm profesional, në funksion të rritjes së sigurisë dhe ofrimit të shërbimeve sa më efikase për qytetarët.



Gjini takon drejtuesit e ZRRE-së, kërkon avancimin e gazsjellësit dhe termocentralit

PRISHTINË, 20 KORRIK - Kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, së bashku me bashkëpunëtorë, zhvilloi të hënën një takim pune me Kryesuesin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe bashkëpunëtorët e tij. Gjatë takimit u diskutua për gjendjen aktuale në sektorin e energjisë dhe për

domosdoshmërinë e shtyrjes përpara të projekteve strategjike që garantojnë stabilitet afatgjatë për vendin. Në fokus të bisedës ishte rëndësia e jetësimit të projektit të gazsjellësit dhe termocentralit, si alternativa jetike për diversifikimin e burimeve të energjisë dhe rritjen e sigurisë energjetike

në Kosovë.

Gjini theksoi se sektori i energjisë kërkon vizion të qartë dhe vendime që mbrojnë interesin e qytetarëve dhe ekonomisë së vendit.

Në përfundim të takimit, ai falënderoi zyrtarët e ZRRE-së për mikpritjen dhe diskutimin profesional.



FERMERËT ANKOHEN PËR VËSHTIRËSI, THONË SE MULLINJTË NUK PO PRANOJNË GRURIN

PRISHTINË, 20 KORRIK - Në kulmin e sezonit të korrje-shirjeve, bujqit në vendin tonë po përballen me krizë në grumbullimin e rendimenteve. Shumë mullinj po refuzojnë ta pranojnë grurin, çmimi i të cilit ka rënë në 16 deri në 18 centë për kilogram, vlerë kjo që nuk i mbulon as kostot e larta të prodhimit. Kombajnat dhe makineritë përcjellëse të procesit të korrje-shirjes nuk po arrijnë të punojnë me kapacitet të plotë, pikërisht në kohën e sezonit. Disa mullinj nuk po e pranojnë grurin nga fermerët, duke u arsyetuar me mungesë të hapësirave për

deponim. “Dje e kam lutur vetëm t’i them: ‘Të lutem, se ka nisur njëfarë shiu të bjerë’. Vinte prej Lipjanit dhe më tha se nuk kam ku ta lë, i kam 10-15 hektarë, nesër kam për të filluar dhe nuk kam ku ta dërgoj. Nuk mundem të bëjë zgjidhje. Këto janë ato që po na rëndojnë, sepse nuk kemi ku ta plasojmë”, tha Behgjet Kongjeli, fermer nga Janjeva. Fitim Gashi, kombajnier tha se kështu nuk mund të vazhdojnë. “Sa i përket çmimit, disa e marrin 18, disa 17 e disa 16 centë, por në fund nuk po e shikojmë vetëm çmimin, por të kemi ku ta largojmë nga ara dhe ta



deponojmë”, tha Gashi.

E Sadik Gashi, fermer nga Akllapi i Lipjanit tha se duhet ta zbrazë grurin diku në oborr për ta larguar nga ara. “Kjo është zgjidhja e fundit. A është zgjidhja e duhur? Jo, por nuk ke çfarë të bësh, duhet të gesh një mënyrë”, tha Gashi.

Ministria e Bujqësisë, përmes pagesave direkte, synon nxitjen e fermerëve për rritjen e prodhimit vendor. Megjithatë, mungesa e hapësirave për grumbullim po vazhdon t’i sfidojë bujqit, të cilët kërkojnë veprime institucionale për mbrojtjen dhe përkrahjen e prodhimit vendor. (rtk)

ÇFARË FSHIHET PAS FRUTAVE DHE PERIMEVE QË BLEJMË ÇDO DITË?

PRISHTINË, 20 KORRIK - Çdo ditë në tryezat e qytetarëve përfundojnë fruta dhe perime, të cilat konsiderohen ndër ushqimet më të rëndësishme për një jetë të shëndetshme. Por, përtej pamjes së tyre të freskët dhe ngjyrave që tërheqin konsumatorët, mbetet një pyetje: sa të sigurt janë në të vërtetë produktet që konsumojmë? Pesticidet janë pjesë e procesit bujqësor, pasi përdoren për mbrojtjen e kulturave nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Megjithatë, përdorimi i tyre jashtë rregullave ose tejkalimi i kufijve të lejuar të mbetjeve

mund të paraqesë shqetësim për shëndetin e konsumatorëve. Për të garantuar sigurinë e produkteve që arrijnë në treg, kontrollet institucionale dhe analizat laboratorike luajnë një rol të rëndësishëm. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë thotë se produktet vendore dhe ato të importuara i nënshtrohen kontrolleve zyrtare, përmes marrjes së mostrave dhe testimit për mbetjet e pesticideve. Por sa janë të informuar qytetarët për këtë çështje dhe çfarë thonë ekspertët për përdorimin e pesticideve në bujqësi? Për këtë temë, KosovaPress ka biseduar me



zyrtarë të AUV-së, ekspertë të bujqësisë dhe përfaqësues të Organizatës “Konsumatori”. Ushtruesi i detyrës së shefit të Inspektoratit Fitosanitar nga AUV, Burim Ahmeti thotë për KosovaPress, se mbrojtja e

shëndetit të konsumatorëve është prioritet i institucionit, ndërsa kontrollet kryhen përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe analizës së rrezikut. Sa i përket frutave dhe perimeve që mund të paraqesin rrezik më të lartë nga mbetjet e pesticideve, ai thotë se kontrollet nuk fokusohen në kultura të caktuara, por zbatohen për të gjitha produktet bujqësore. Sipas tij, deri më tani nuk janë evidentuar raste të tejkalimit të normave të lejuara. Sipas tij, respektimi i rregullave nga fermerët verifikohet përmes inspektimeve zyrtare, kontrollit

të dokumentacionit dhe analizave laboratorike, ndërsa në rast të shkeljeve zbatohen masat e parashikuara me ligj. Mungesa e informimit të qytetarëve dhe kontrollet e pamjaftueshme institucionale mbeten ndër shqetësimet kryesore sa i përket sigurisë së frutave dhe perimeve në Kosovë, vlerëson kryetari i Organizatës “Konsumatori”, Selatin Kaçaniku. Ai shpreh dyshime edhe për nivelin e kontrolleve që kryhen në treg, duke theksuar se institucionet nuk mund ta mbikëqyrin tregun pa bashkëpunimin e qytetarëve.

Hapen programet e zhvillimit të aftësive për përfituesit e ndihmës sociale

PRISHTINË, 20 KORRIK - Ministri për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, ka njoftuar se ministria që drejton ka publikuar Thirrjen Publike për Ofrimin e Programeve të Zhvillimit të Aftësive për Përfituesit e Programit të Ndihmës Sociale, me qëllim që të lehtësojnë integrimin e tyre në tregun e punës. “Synimi ynë është i qartë, qytetarëve të aftë për punë t’u krijojmë mundësi reale për të fituar një profesion, për t’u punësuar dhe për të ndërtuar një të ardhme më të

sigurt për familjet e tyre. Gjatë zbatimit të Projektit për Reformën e Asistencës Sociale kemi identifikuar se një pjesë e përfituesve kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm të shkathtësive profesionale dhe për programe trajnimi të përshtatura me kërkesat e tregut të punës”, ka shkruar Hoti në “Facebook”. Ai ka theksuar se trajnimet do të organizohen në profesione që kërkojnë realisht në tregun e punës, në të shtatë rajonet e Kosovës. “Ato do të përmbajnë së paku 200 orë mësim teorik

dhe praktik, certifikim profesional, si dhe mbështetje konkrete për punësim. Ftoj të gjithë ofruesit jopublikë të trajnimeve, të akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ose nga institucione ndërkombëtare të akreditimit, që të aplikojnë deri më 7 gusht 2026, në orën 16:00. Kjo reformë krijon një qasje tjetër të shtetit ndaj mbrojtjes sociale. Nga mbështetja vetëm për të përballuar muajin, te krijimi i mundësive për të ndërtuar të ardhmen e tyre”, ka theksuar Hoti.



PSE NATO DO TË JETË GJITHNJË E MË EUROPIANE



Nathalie TOCCI

Është një samit i NATO-s ku mungesa e lajmeve është vetë lajmi. Programi i Ankarasë është reduktuar në minimum: sa më pak kohë për diskutime dhe sa më e shkurtër deklarata përfundimtare, aq më i vogël rreziku.

Rreziku, ose më saktë kërcënimi, nuk vjen nga ajo që mund të bëjnë armiq si Vladimir Putini, por nga ajo që mund të thotë "aleati" Donald Trump.

Është punuar me kujdes për ta shmangur këtë. Presidenti amerikan kërkonte që partnerët europianë dhe kanadezë të shpenzonin më shumë për mbrojtjen, dhe pikërisht këtë po bëjnë. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, paraqet shifra mbresëlënëse. Pa llogaritur Shtetet e Bashkuara, vendet anëtare të NATO-s kanë shpenzuar plot 139 miliardë dollarë më shumë për mbrojtjen vetëm gjatë vitit të kaluar.

Një pjesë e mirë e këtyre fondeve ka përfunduar në industrinë amerikane të mbrojtjes, duke krijuar afro 200

mijë vende pune në SHBA. Këto shifra janë përsëritur pa pushim gjatë samitit, me një qëllim të vetëm: të zbusin Trumpin dhe ta bindin se nuk po mashtrohet.

Pak vetë besojnë se kjo mjafton për të garantuar një angazhim real amerikan për mbrojtjen e aleatëve europianë, nëse do të lindte nevoja. Dhe askush nuk e përjashton mundësinë që kjo nevojë të shfaqet. Aq më tepër nëse Ukraina arrin të mbrohet gjithnjë e më mirë, duke krijuar një ngjirje de facto të vijës së frontit.

Putini, i cili nuk mund ta përballojë një fund të luftës nga e cila varet mbijetesa e regjimit të tij, mund të tundohet ta zhvendosë konfliktin diku tjetër, ndoshta duke kaluar kufijtë drejt një vendi të NATO-s. Por ka gjithnjë e më pak shpresa se një heshtje amerikane do ta pengonte atë të ndërmerre një hap të tillë.

Përtej spektaklit tragjikomik, thelbi është një tjetër. Është e qartë se Shtetet e Bashkuara duan të tërhiqen nga siguria europiane, si për shkak të prioritetëve, ashtu edhe të kostove. Po aq i pashmangshëm duket edhe fati i një NATO-je shumë më të

europianizuar. Sot SHBA-të sigurojnë rreth gjysmën e forcave konvencionale në Europë. Ka gjasa që brenda pak vitesh, edhe pse gradualisht, kjo prani të përgjysmohet, ndërsa ombrella bërthamore amerikane në Europë do të mbetet e pandryshuar. Është një skenar optimist, por në thelb realist. NATO do të jetë ndoshta më e dobët, por më europiane, dhe gjithsesi mjaftueshëm e fortë për të mbrojtur kontinentin nga kërcënimi rus. Në fund të fundit, ky është objektivi drejt të cilit po punohet.

Megjithatë, ekzistojnë dy nyje që rrezikojnë të minojnë të ardhmen e Aleancës, edhe nëse ajo bëhet më europiane.

E para do të vihej në provë në rast se Rusia do të sulmonte një vend të NATO-s në muajt apo vitet e ardhshme. Një situatë e tillë do të rrezikonte një përçarje brenda Aleancës. Nëse do të sulmoheshin, për shembull, vendet baltike, për të mos folur për Poloninë, dhe nëse Shtetet e Bashkuara do të qëndronin mënjanë, ka shumë gjasa që Gjermania, ku riarmatimi tashmë është realitet, të mbetet besnike ndaj angazhimit për mbrojtjen

kolektive. Pas saj do të vinin edhe Franca dhe Mbretëria e Bashkuar, duke e bërë shumë të mundshme që edhe vendet e tjera, përfshirë Italinë, t'i bashkoheshin përpjekjes së përbashkët. Kjo do të shënonte fundin e NATO-s si aleancë transatlantike, por jo fundin e një mbrojtjeje kolektive europiane, ku mund të përfshiheshin edhe Kanada dhe ndoshta Turqia.

Nyja e dytë do të shfaqej në një skenar më pak dramatik: lufta në Europë mund të mos zgjerohet përtej Ukrainës, por konflikti me Rusinë është i destinuar të vazhdojë, duke i detyruar europianët të marrin përgjegjësi gjithnjë e më të mëdha për mbrojtjen e kontinentit.

Këtyre përgjegjësi duhet t'u korrespondojë edhe një peshë më e madhe vendim-marrëse brenda Aleancës. Me pak fjalë, një NATO më e europianizuar do të pushonte së qeni një organizatë e drejtuar tradicionalisht nga SHBA-të. Megjithatë, sot kjo nuk është llogaria e Uashingtonit. Zemërimi i Trumpit ndaj aleatëve europianë, të cilët vendosën kufizime modeste për përdorimin e armëve në

luftën kundër Iranit, duke refuzuar të shërbenin si bashkëluftëtarë, tregon bindjen e tij se SHBA janë aksioner shumice i NATO-s. Përlësia e tepruar e Mark Ruttes ndaj Trumpit nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka forcuar këtë bindje në Uashington.

Por nëse nesër europianët do të bëheshin me të vërtetë pjesa dominuese brenda Aleancës, a do të ishin Shtetet e Bashkuara, pavarësisht kush është në Shtëpinë e Bardhë, të gatshme të pranonin një treg europian të mbrojtjes më pak të hapur për industrinë amerikane? Ose që disa vendime operative të NATO-s të mos merreshin më kryesisht nga SHBA? Nëse të drejtat dhe përgjegjësitë nuk ecin paralelisht, rreziku është që të prishet kontrata e pashkuar që mban të bashkuar organizatën.

Kur ua shtroj këtë pyetje kolegëve të NATO-s, ata e pranojnë, por ngrenë supet. Thonë se është një problem që, në rastin më të mirë, do të lindë nesër. Dhe do të jetë tashmë një mrekulli nëse deri atëherë Aleanca do të ketë mbërritur e paprekur. / la stampa



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Kylian Mbappe fiton Këpucën e Artë të Botërorit dhe shkruan historinë

PRISHTINË, 20 KORRIK - Kylian Mbappe ka shkruar histori në Kupën e Botës 2026, duke fituar zyrtarisht Këpucën e Artë pas një paraqitjeje të jashtëzakonshme gjatë turneut. Sulmuesi i Real Madridit e

mbylli Botërorin me plot 10 gola, duke lënë pas Lionel Messin, i cili përfundoi me tetë realizime.

Me këtë sukses, Mbappe bëhet futbollisti i parë në histori që fiton Këpucën e Artë në dy edicione radhazi të Kupës së Botës, duke

konfirmuar dominimin e tij në skenën më të madhe të futbollit.

Në të njëjtën kohë, ai ngriti në 22 numrin e golave të shënuar në 22 ndeshje të Kupës së Botës, duke u bërë golashënuesi më i mirë i të gjitha kohërave në historinë

e këtij kompeticioni.

Ky është një tjetër rekord në një sezon të paharrueshëm 2025/26 për yllin francez, i cili gjithashtu e mbylli edicionin si golashënuesi më i mirë në Ligën e Kampionëve, La Liga dhe Kupën e Botës.



SPANJA KAMPIONE E BOTËS

PRISHTINË, 20 KORRIK - Kombëtarja e Spanjës e ka marrë epitetin e kampiones së botës pasi mposhti në finale Argentinën. "La Roja" triumfoi me rezultat minimal 1-0, sfidë ku u nevojiten edhe vazhdimet. Spanja ishte larg më dominuese për të krijuar shumë raste por që assesi s'ia dolën t'i finalizonin.

Lamine Yamal kishte një rast të mirë shënimi pas vetëm pesë minutave lojë, por që Emiliano Martinez me super pritje ia mohoi golin.

Spanjollët pastaj rrezikuan edhe përmes Ferran Torres e Aymeric Laporte, megjithatë Martinez sërisht ishte në vendin e duhur.

Situata për Argentinën u vështirësua pasi mesfushori Enzo Martinez mori kartonin e dytë të verdhë, kështu gjyqtari e përjashtoi nga loja.

Në kohën shtesë, Spanja realizoi përmes Nico Williams mirëpo goli u anulua shkaku i një faulli në sulm (96').

Heroi i Spanjës rezultoi të jetë Ferran Torres që shënoi me një goditje të fortë pas një topi të kthyer nga Nico Williams (106'). Torres faktikisht shënoi edhe një tjetër herë, por goli u anulua për pozitë jashtë loje.

Kështu, Spanja e merr epitetin e kampiones së botës, për ta dëshmuar vetën se është ekipi më i fortë në botë.



PRISHTINA ZYRTARIZON AGRON RUFATIN, QENDËRMBROJTËSI I BASHKOHET BARDHEKALTËRVE NË TURQI

PRISHTINË, 20 KORRIK - FC Prishtina ka zyrtarizuar transferimin e qendërmbrojtësit Agron Rufati, i cili tashmë i është bashkuar skuadrës në Bolu të Turqisë, aty ku ekipi po zhvillon fazën përgatitore në prag të sezonit të ri.

Mbrojtësi 27-vjeçar vjen te bardhekaltrit me një përvojë të pasur ndërkombëtare. Gjatë karrierës së tij ai ka luajtur për ND Gorica në Slloveni, NK Istra në Kroaci, Zorya Luhansk në Ukrainë, Academia Clinceni në Rumani, Brera Strumica në Maqedoninë e Veriut dhe së fundmi për Dynamo City në Shqipëri.



Rufati është produkt i akademisë së njohur të Dinamo Zagrebit, ku ishte pjesë e ekipeve U17 dhe U19, ndërsa ka përfaqësuar edhe Maqedoninë e Veriut me grupmoshat U19 dhe U21.

Pas zyrtarizimit, mbrojtësi u shpreh i lumtur për transferimin te Prishtina, duke e cilësuar klubin si më të madhin

në Kosovë.

Ai falënderoi drejtuesit për besimin e dhënë dhe premtoi se do të japë maksimumin në çdo stërvitje dhe ndeshje për të mbrojtur me krenari fanellën bardhekaltrë.

Rufati theksoi se është i vetëdijshëm për peshën dhe përgjegjësinë që mbart fanella e Prishtinës, ndërsa shtoi se synimi i tij është të ndihmojë ekipin në arritjen e objektivave dhe fitimin e trofeve.

Klubi e ka mirëpritur futbollistin me mesazhin: "Mirë se erdhe në shtëpinë tënde të re, Agron! Të urojmë shumë suksese me fanellën bardhekaltrë."

SHPATI ZEKAJ FITON MEDALJEN E BRONZTË PËR KOSOVËN NË KUPËN BOTËRORE TË XHUDOS NË SARAJEVË

PRISHTINË, 20 KORRIK - Xhudisti kosovar Shpati Zekaj ka fituar medaljen e bronzit në European Open Sarajevo 2026, duke shënuar një tjetër sukses të rëndësishëm për sportin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Në kategorinë deri në 100 kilogramë, Zekaj zhvilloi paraqitje të shkëlqyer, duke mposhtur garues nga Rusia, Serbia dhe Gjermania, për t'u ngjitur në podium dhe për të fituar medaljen e bronzit në këtë garë të vlefshme për renditjen botërore dhe rrugëtimin drejt kualifikimit olimpike.

Në këtë garë Kosovën e



përfaqësoi edhe Dardan Cena, i cili, pavarësisht paraqitjes së mirë, mbeti pa medalje.

Ministria e Sportit dhe Rinisë përgëzon Shpat Zekajn, Federatën e Xhudos së Kosovës, trajnerët dhe gjithë ekipin për këtë sukses të radhës, duke u uruar arritje edhe më të mëdha në garat e ardhshme ndërkombëtare.

Ahmed Januzi rikthehet te Llapi, emërohet asistent trajner

Prishtinë, 20 korrik- KF Llapi ka zyrtarizuar rikthimin e Ahmed Januzit në klub, kësaj radhe në një rol të ri, duke u emëruar asistent trajner në shtabin teknik të skuadrës bardhekaltrë. Pas një karriere të suksesshme si futbollist, Januzi rikthehet në klubin ku ka lënë gjurmë të

rëndësishme, pasi ka mbrojtur fanellën e Llapit për katër vite në tri periudha të ndryshme.

Nga klubi vlerësojnë se përvoja e tij në fushën e lojës, njohja e ambientit dhe lidhja e veçantë me Llapin do të jenë një vlerë e shtuar për ekipin.

Së fundmi, Januzi ka

përfunduar me sukses edukimin trajnerial pranë FSHF-së, duke u pajisur me licencën UEFA A, duke nisur kështu një kapitull të ri në karrierën e tij si trajner.

Klubi ka shprehur bindjen se profesionalizmi, përkushtimi dhe përvoja e Januzit do të

ndihmojnë në arritjen e objektivave për sezonin e ri.

Ndërkohë, KF Llapi ka njoftuar edhe përfundimin e bashkëpunimit me Sunaj Keqin, të cilin e ka falënderuar për kontributin e dhënë si asistent trajner dhe i ka uruar suksese në vazhdim të karrierës së tij.





Shqiptarë Humanitarë - Bashkë me Kosovën "Mëta Teresa"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarë Dëshpërues Udhëzues Kosovë "Mëta Teresa"
38400 Prishtinë Rr. Agim Ramadani po. Tel:00381 38 542 864. Fax:542 869.
Web site: www.metheresasociety.org e-mail:metheresasociety@yahoo.com

CONTRACT NOTICE

SERVICES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 20/07/2026

Procurement No	Training	002	2026	221
----------------	----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English x

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code:10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone:038-542-865	
Email: zefshala@hotmail.com	Fax:038-542-869	
Internet address (if applicable):	www.matherteresasociety	

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Professional training for 300 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo		
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)		
		X Services
II.1.5) Short description of the object of the contract Professional training for 300 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo		
II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) 93.000.000.-8		
II.1.7) Variants are accepted	No	x
II.1.8) Division into lots	NO	x
Professional training for 300 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo		
II.1.11) Estimated contract value: Approximately 29,500.00		

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 2 month (from the contract signature) or
Starting 15/08/2026
Completion 15/10/2026

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

III.1.1) Performance security required	NO
III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)	
III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject	No ☒

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1) Eligibility Requirements:

1. Certificate of Business Registration
2. Fiscal Number Registration
3. VAT-Certificate if applicable

Documentary evidence required

Copy of documentary

III.2.2) Professional Suitability:

1. Business Registration Certificate
2. List of proposed experts and administrative staff and their cv-s
3. References of previous experience in similar projects

Documentary evidence required:

Copy of prove documents

III.2.3) Economic and financial capacity

1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo (for Winner Company only)
2. Certificate from Justice that's Company and person representative is not on any justice process (for Winner Company only)
3. Company profile

Documentary evidence required:

Copy of documentary

III.2.4) Technical and professional capacity

1. Business Registration Certificate
2. List of proposed experts and administrative staff and their cv-s
3. References of previous experience in similar projects

Documentary evidence required:

Copy of prove documents

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession	No ☒
III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service	Yes ☒

SECTION IV: PROCEDURE

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of Procedure
Open

IV.2) AWARD CRITERIA

Lowest price

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract	No ☒
IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier Time limit for receipt of requests for tender dossier: date 24/07/2026	
Payable documents	No ☒
IV.3.3) Time limit for receipt of tenders Date 10/06/2026 time 14:00 place Prishtina	
IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tenders ☒ no	
IV.3.5) Is tender security needed:	No ☒
IV.3.6) Tender validity period: date: 05/08/2026 days 30 or months1	
IV.3.7) Tender opening meeting: Date 05/08/2026 time 14:30 place Prishtina	

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

